

**PROGRAMI
MËSIMOR**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Viti I

Shkup, Qershor 2013

**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
3 VJEÇARE**

I. HYRJE

(Të dhënat kryesore për lëndën mësimore)

Emërtimi i lëndës mësimore: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Lloji i arsimit të mesëm: profesional

Viti i mësimit të lëndës mësimore: Viti I

Numri i orëve të lëndëve mësimore:

- numri i orëve javore: **3 orë**
- numri i orëve vjetore: **108 orë**

Statusi i lëndës mësimore: e detyrueshme

II. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE (nga viti I deri në vitin III)

Nxënësit/ nxënëset:

- të fitojnë njohuritë themelore (më të domosdoshme) nga lëma e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe botërore;
- t'i thellojnë njohuritë paraprake nga lëmi i gjuhës dhe letërsisë shqipe e botërore;
- të vetëdijësohen për rëndësinë e përvetësimit të mirë të gjuhës dhe letërsisë për karrierë dhe jetë të suksesshme;
- të aftësohen të komunikojë në shqipen standarde me gojë dhe me shkrim;
- të aftësohen për të komunikuar lirshëm me veprat letrare-artistike dhe për t'i komentuar/ analizuar ato;
- të aftësohet për mësim të pavarur...

III. QËLLIMET E LËNDËS GJATË VITIT MËSIMOR

Nxënësit/ nxënëset:

- të njihen me gjuhën si mjet kryesor komunikimi ndërmjet njerëzish;
- ta kuptojnë se gjuha shqipe bën pjesë në mesin e gjuhëve indoevropiane;
- të njihen me karakteristikat e gjuhës popullore, gjuhës letrare dhe shqipes standarde;
- të njihen me fonetikën dhe objektin e studimit të saj;
- t'i klasifikojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes dhe t'i përdorin drejt ato;
- ta kuptojnë rendin e drejtë të gjymtyrëve në fjali, sipas rregullave gramatikore të shqipes;
- të njihen me morfologjinë si pjesë e gramatikës dhe me objektin e studimit të saj;
- t'i dallojnë klasat e fjalëve (fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme);
- të njihen me mënyrat e formimit të fjalëve;
- të njihen me kategoritë gramatikore të emrit: gjininë, numrin, rasën, trajtën;
- të njihen me foljen, me klasifikimin dhe kategoritë gramatikore të saj;
- të aftësohen t'i përdorin drejt foljet gjatë të folurit dhe të shkruarit...

*

- të njihen me letërsinë si art i fjalës;
- të njihen me fillet e letërsisë botërore e shqiptare dhe me udhën zhvillimore të letërsisë;
- të njihen me llojet e artit letrar dhe me shkencat që merren me studimin e letërsisë;
- të njihen me strukturën e veprave letrare të zhanreve të ndryshme;
- të dallojnë temën dhe idenë e veprës letrare;
- të njihen me gjininë epike;
- të njihen me lirikën dhe me karakteristikat e saj;
- të njihen me gjininë dramatike dhe llojet e saj;
- të njihen me figurat më të thjeshta letrare;
- të njihen me folklorin dhe llojet e tij;
- të njihen me dëshmitë, dokumentet dhe tekstet e para të shkruara në gjuhën shqipe;
- të njihen me rrethanat në të cilat u lind letërsia shqipe;
- të njihen me veprimtarinë letrare të autorëve të Letërsisë së vjetër shqipe;
- të njihen me fillet e letërsisë botërore dhe me veprat kryesore të saj;
- të fitojnë shprehje leximi të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj;
- të komentojnë lëktyrat e lexuara...

IV. QËLLIMET KONKRETE

Nxënësit/ nxënëset:

Fusha programore: GJUHË (54 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
- të njihen me gjuhën dhe shkencën që e studion atë; - ta kuptojnë se gjuha shqipe bën pjesë në mesin e gjuhëve indoevropiane; - të njihen me gjuhën si mjet kryesor komunikimi ndërmjet njerëzish...	GJUHËSIA Gjuha dhe rëndësia saj	- shkenca mbi gjuhën - komunikimi	- Ushtrime për përcaktimin e pozicionit të gjuhës shqipe në drurin e gjuhëve I.E.
- të njihen me karakteristikat e gjuhës popullore dhe asaj letrare; - të dallojnë gjuhën popullore dhe letrare prej shqipes standarde; - të njihen me udhën e vështirë të shqipes standard...	Gjuha popullore, gjuha letrare dhe shqipja standarde	- gjuha popullore - gjuha letrare - shqipja standarde	-Lexime nga libra të ndryshëm folklorik dhe komentimi i tyre.
- të njihen me fonetikën si shkencë dhe me objektin e studimit të saj; - ta njohin sistemin tingullor të shqipes...	FONETIKA dhe objekti i studimit të saj	- fonetika - fonologjia	- Ushtrime për sistemin tingullor të shqipes.
- të aftësohen të dallojnë organet e të folurit dhe funksionin e tyre...	Organet e të folurit	- aparati i të folurit	- Ushtrime për njohjen e organeve të të folurit.
- t'i njohin tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe...	Tingujt dhe fonemat	- tingujt - fonemat	- Ushtrime për dallimet midis tingujve dhe fonemave.

- t'i njohin zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes	Llojet e tingujve	- zanoret - bashkëtingëlloret	- Leximi i fjalëve të ndryshme ku do të dallojmë zanoret nga bashkëtingëlloret.
- t'i klasifikojnë zanoret e gjuhës shqipe dhe t'i përdorin drejt ato...	Zanoret - klasifikimi	- klasifikimi i zanoreve	-Vizatimi ne tabelë i trekëndëshit ku do të pozicionohen zanoret.
- te njihen me klasifikimin e bashkëtingëlloreve dhe drejtpërdorimin e tyre...	Bashkëtingëlloret dhe klasifikimi i tyre	- klasifikimi i bashkëtingëlloreve	- Ushtrime për vendosjen e bashkëtingëlloreve në pozicionet ku artikuloohen.
- të përdorin drejt theksin; - të ndajnë drejt fjalët në rrokje...	Rrokja dhe theksi në gjuhën shqipe	- rrokja - theksi	- Ushtrime për ndarjen e fjalëve në rrokje. - Ushtrime për gjetjen e theksit në fjalë të ndryshme.
- të njihen me morfologjinë si pjesë e gramatikës dhe me objektin e studimit të saj...	MORFOLOGJIA dhe objekti i studimit të saj	- morfologjia	- Lexim për morfologjinë dhe objektin e studimit të saj.
- t'i dallojnë klasat e fjalëve (fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme); - t'i kuptojnë funksionet e gjymtyrëve të ndryshme në fjali...	- Klasat e fjalëve	- klasa e fjalëve	- Ushtrime për fjalët dhe dallimin e tyre në pjesë të dryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës.

- të njihen me mënyrat e formimit të fjalëve;	Fjalëformimi	- fjalëqformimi	- Ushtrime për mënyrat e ndryshme të formimit të fjalëve.
- t'i njohin pjesët e fjalëve... - të dallojnë rrënjën dhe temën e fjalës	Rrënja dhe tema e fjalës	- rrënja e fjalës	- Ushtrime për dallimin e rrënjës nga tema e fjalës me shembuj të ndryshëm
- të aftësohen të formojnë fjalë të reja me ndihmën e parashtesave dhe prapashtesave...	Parashtesa dhe prapashtesa	- parashtesa - prapashtesa	- Gjetja e parashtesave dhe prapashtesave dhe formimi i fjalive të reja me to.
- të dallojnë nga njëra-tjetra fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura;	Fjalët e prejardhura, fjalët e përbëra dhe fjalët e përngjitura	- fjalët e prejardhura - fjalët e përbëra - fjalët e përngjitura	- Ushtrime për fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura me shembuj.
- të njihen me kuptimet gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës që shprehen me anë të formave gramatikore	Kuptimet dhe format gramatikore	- kuptimet gramatikore - format gramatikore	- Jepen ushtrime ku nxënësit do të duhet të gjejnë kuptimet gramatikore.
- të njihen me kategoritë gramatikore të emrit: gjininë, numrin, rasën, trajtën...	Emri (kategoritë gramatikore)	- kategoritë gramatikore	- Ushtrime për njohjen dhe përvetësimin e

			katëgorive gramatikore të emrit.
- të dallojnë gjininë e emrave; - t'i përdorin drejt emrat gjatë të folurit dhe të shkruarit...	Gjinia e emrit	- gjinia e emrit	- Ushtrime për gjetjen e gjinisë së emrit dhe dallimin e gjinisë natyrore nga ajo gramatikore.
- të njihen me mënyrën e formimit të shumësit të emrave me anë të parashtesave trajtëformuese, me anë të ndërrimeve fonetike në temën e emrave, me ndërrimin e tingujve në temë dhe të parashtesave njëkohësisht; - të njihen me emrat që përdoren njësoj në të dy numrat...	Formimi i shumësit të emrave	- numri i emrit	- Ushtrime për përdorimin praktik të numrit njëjës dhe shumës.
- të aftësohen të lakojnë emrat në numrin njëjës dhe në numrin shumës...	Lakimi i emrit	- lakimi i emrit	- Ushtrime praktike për të lakuar emra të ndryshëm në rase.
- të njihen me foljen, me klasifikimin dhe kategoritë gramatikore të saj...	Folja (klasifikimi)	- folja	- Ushtrime praktike për klasifikimin e foljeve në zgjedhime
- të njihen me sintaksën si pjesë e gramatikës dhe me objektin e studimit të saj...	SINTAKSA dhe objekti i studimit të saj	- sintaksa	- Të dallojë objektin e studimit të sintaksës.
- të njihen me fjalinë e thjeshtë dhe me fjalinë e thjeshtë të zgjeruar;	Fjalja e thjeshtë	- fjalja e thjeshtë - fjalja e thjeshtë e zgjeruar	- Ushtrime për përvetësimin e mënyrave të ndryshme të formimit të fjalive të thjeshta. - Ushtrime gojore dhe

			me shkrim për përdorimin e drejtë të fjalive të thjeshta.
- të njihen me gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe me funksionin e tyre	Kryefjala dhe kallëzuesi	- kryefjala - kallëzuesi	- Ushtrime për gjetjen e kryefjalës dhe kallëzuesit.
- ta kuptojnë rendin e drejtë të gjymtyrëve në fjali, sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe...	Struktura e fjalisë së thjeshtë... (rendi i gjymtyrëve në fjali)	- struktura gramatikore - rregulla gramatikore	- Ushtrime për fjalitë dhe rendin e gjymtyrave në fjali.
- të njihen me kundrinorin dhe përcaktorin; - ta kuptojnë rolin e tyre në fjali; - të dallojnë llojet e kundrunorit dhe të përcaktorëve...	Kundrinori dhe përcaktorin	- kundrinori - rrethanori	- Ushtrime për dallimin e rrethanorit dhe përcaktorit në fjali.
- të aftësohen të shfaqin origjinalitet dhe imagjinatë në të shprehur... - të njihen me mënyrat e shkrimit të hartimeve, me gjuhën më të përshtatshme për një hartim të suksesshëm; - të përdorin drejt shenjat e pikësimit; - të aftësohen të bëjnë renditjen logjike të gjërave dhe të përdorin shprehje sa më të kapshme e më të qarta...	Hartimet me shkrim Gjatë vitit do të bëhen 3 hartime	- hartimi	-Ushtrime përgatitore për hartim...
KOMUNIKIM			

<p>Të aftësohen të komunikojnë lehtë me gojë dhe me shkrim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • CV (biografia) • paraqitja në konkurs • kërkesa • lutja • lajmërimi • ankesa • raporti • urimi • letra • plotësimi i çeqeve dhe formularëve 	<p>Biseda private dhe ato në punë (rregullat elementare të bashkëbisedimit)</p> <p>Shkrimi/plotësimi i dokumentave të punës dhe i shkresave administrative...</p>	<p>- komunikimi</p> <p>- konkursi</p> <p>- kërkesa</p> <p>- lutja</p> <p>- lajmërimi</p> <p>- ankesa</p> <p>- raporti</p> <p>- urimi</p> <p>- letra</p> <p>- formularët</p>	<p>- Simulimi i bisedave të ndryshme për ushtrimin e përdorimit të drejtë të gjuhës gjatë komunikimit...</p> <p>- Shkrimi i letrave dhe shkresave të ndryshme...</p>
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Fusha programore: LETËRSI (54 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>- të njihen me letërsinë si art;</p> <p>- të njihen me fillet e letërsisë botërore e shqiptare dhe me udhën zhvillimore të letërsisë;</p>	<p>Teoria e letërsisë</p> <p>Arti dhe zanafilla e tij; llojet e artit;</p> <p>Historia e letërsisë, Teoria e letërsisë dhe Kritika letrare.</p>	<p>- arti</p> <p>- historia e letërsisë</p> <p>- teoria e letërsisë</p> <p>- kritika letrare</p>	<p>- Të lexojë krijime artistike të gjinive të ndryshme letrare...</p>

- të njihen me llojet e artit letrar dhe me shkencat që merren me studimin e letërsisë...			
- t'i njohin stilet e ndryshme të të shprehurit...	Gjuha dhe stili - stili funksional (stili tekniko-shkencor, administrativ, publicistik, artistik...)	- stili i të shprehurit...	- Diskutime për dallimin e stileve të ndryshme letrare.
- të njihen me të shprehurit kreativ; - të komunikojnë natyrshëm me veprat artistike...	Stili artistik dhe roli i figurës...	- të shprehurit kreativ - vepra artistike	- Ushtrime praktike...
- të njihen me strukturën e veprave letrare të zhanreve të ndryshme; - të dallojnë temën dhe idenë e veprës letrare; - të njihen me kompozicionin dhe elementet tjera të rëndësishme që ndihmojnë komunikimin me veprat e artit...	Struktura e veprës letrare: përmbajtja dhe forma, tema dhe ideja...	- struktura e veprës letrare - tema - ideja e veprës letrare	- Ushtrime dhe diskutim me nxënësit me qëllim dallimin e koncepteve „formë,, „ide,, në veprën letrare.
- të njihen me gjininë epike; - të dallojnë llojet e epikës në vargje dhe në prozë...	Gjinitë dhe llojet letrare Epika në vargje (vepra homerike – "Iliada", kënga VI) Epika në prozë (përralla, skica, tregimi, novela, romani...)	- gjinitë letrare - llojet letrare - epika	- Lexim nga krijime letrare të ndryshme me qëllim dallimi në mes veprës në vargje dhe asaj në prozë.
- të njihen me lirikën dhe me karakteristikat e saj; - të komunikojnë natyrshëm me vargjet lirike...	Lirika (karakteristikat, rrokja, rima, strofa...)	- lirika - strofa - rima - rrokja	- Leximi i krijimeve lirike dhe njohja e elementeve të tyre...

- të njihen me llojet e lirikës...	Llojet e lirikës (elegjia, balada, himni...)	- elegjia - balada - himni	- Ushtime ku nxënësit do të krijojnë vargje të ndryshme të rimuara.
- të njihen me gjininë dramatike dhe llojet e saj; - t'i dallojnë elementet karakteristike të veprave dramatike...	Drama (karakteristikat dhe llojet e kësaj gjinie – tragjedia, komedia dhe drama)	- drama - tragjedia - komedia	- Diskutim për dallimin e llojeve të dramës dhe ndjekja e një dramë në teatër ose në klasë.
- të njihen me figurat më të thjeshta letrare; - të aftësohen t'i përdorin ato në të shprehurit e tyre me gojë dhe me shkrim...	Figurat stilistike (krahasimi, metafora, personifikimi, alegoria, simboli, antiteza, hiperbola...)	- tropet - figurat stilistike	- Ushtime dhe lexime për njohjen më të mirë të nxënësve me figurat letrare...
- të njihen me folklorin dhe llojet e tij...	Folklori (llojet e folklorit...)	- folklori	- Diskutim mbi atë se çka dijmë për folklorin nga gjyshërit e nga gjyshet.
- të njihen me lirikën familjare dhe atë shoqërore...	Lirika familjare dhe shoqërore (veçoritë)	- lirika familjare - lirika shoqërore	- Diskutim për këngët e dasmës, djepit, dashurisë, gurbetit...
- të njihen me epikën legjendare dhe veçantitë e saj...	Epika legjendare - eposi i kreshnikëve... (baza historike, personazhet, elementet karakteristike...)	- epika legjendare - eposi i kreshnikëve	- Ushtime për dallimin e epikës legjendare nga ajo kreshnike...

- të njihen me dëshmitë, dokumentet dhe tekstet e para të shkruara në gjuhën shqipe...	Fillet e letërsisë shqipe	- dëshmitë... - dokumentet - tekstet e para të shqipes së shkruar	- Diskutim dhe lexim i dokumenteve të para të shkruara në gjuhën shqipe...
- të njihen me Rilindjen evropiane...; - të njihen me letërsinë shqipe të krijuar në gjuhën latine...		- humanizmi shqiptar	- Lexim fragmentesh nga letërsia e humanizmit shqiptar me qëllim të njohjes dhe dallimit të kësaj periudhe.
- të njihen me veprimtarinë letraro-historike të Marin Barletit, Marin Beçikemit...; - të lexojnë fragmente të veprës së Barletit: "Historinë e Skënderbeut"...	Humanizmi shqiptar: Marin Barleti – vepra letraro-historike	- vepra letraro-historike	- Lexim nga Marin Barleti dhe diskutim për veprën e tij.
- të njihen me rrethanat në të cilat u lind letërsia shqipe;	Letërsia e vjetër shqipe	- letërsia e vjetër shqipe	- Lexim nga pjesë të ndryshme të kësaj letërsie, autorë të ndryshëm të kësaj periudhe.
- ta njohin rëndësinë e "Meshari-t" të Gjon Buzukut për gjuhën dhe kulturën shqiptare...	Gjon Buzuku (jeta dhe vepra letrare)	- meshari...	- Diskutim dhe lexim nga Meshari i Gjon Buzukut dhe komentim bashkë me nxënësit.

- të fitojnë njohuritë bazike mbi veprimtarinë letrare të autorëve të Letërsisë së vjetër shqipe...	Pjetër Budi Frang Bardhi Pjetër Bogdani	- letërsia kishtare - letërsia laike	- Lexim komentim nga veprat e autorëve në fjalë...
- ta njohin krijimtarinë letrare të bejtexhinjëve; - të dallojnë karakteristikat e saj; - të aftësohen t'i komentojnë veprat kryesore të bejtexhinjëve ("Erveheja", "Paraja", "Trahani"...))	Letërsia shqipe me alfabetin turko-arab Muhamet K. çami Hasan Z. Kamberi Nezim Frakulla	- bejtexhinjtë...	- Ushtrime për dallimin në mes letërsie së bejtexhinjëve dhe asaj kishtare.
- të njihen me fillet e letërsisë botërore dhe me veprat kryesore të saj... - të posedojnë njohuritë bazike mbi veprat më të vjetra letrare si "Epi i Gilgameshit"...	Letërsia botërore dhe fillet e saj	- letërsia botërore	- Lexim fragmentesh nga letërsia e vjetër botërore...
- të njihen me kohën dhe rrethanat e lindjes së letërsisë antike greke; - të njihen me tiparet dalluese të kësaj letërsie...	Letërsia antike greke	- letërsia antike greke - mitet...	- Lexime dhe komentime të pjesëve të zgjedhura nga kjo letërsi...
- të njihen me autorët dhe veprat më të njohura të letërsisë antike greke; - të njihen me veprën homerike dhe me karakteristikat e saj; - të njihen me rolin e kësaj letërsie në zhvillimet e mëvonshme letrare e kulturore...	Homeri: "Iliada" dhe "Odiseja" Sofokliu: "Antigona"	- vepra homerike	- Lexim nga Iliada dhe komentim i vargjeve. - Komentimi i filmit të xhiruar me bazë veprën e autorit - Komentim për personazhin Antigona...
- të njihen me letërsinë antike romake dhe me rrethanat e lindjes së saj...	Virgjili: "Eneida"	- letërsia antike romake	- Lexime pjesësh të zgjedhura të

<p>- të fitojnë shprehi leximi të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj; - të komentojnë lëktyrat e lexuara; - ta përcaktojnë vendin dhe kohën e ngjarjes në veprën e lexuar; - ta përcaktojnë temën dhe idenë e veprave në vargje dhe në prozë; - ta përcaktojnë llojin dhe gjininë e veprës së lexuara; - të diskutojnë e të shkruajnë për përmbajtjen e veprës së lexuar dhe për karakterin e personazhëve....</p>	<p>LISTA E LEKTYRAVE:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Naim Frashëri - <i>“Lulet e verësë”</i> - Pashko Vasa - <i>“Bardha e Temalit”</i> - Sami Frashëri - <i>“Dashuria e Talatit me Fitneten”</i> - Sterjo Spasse - <i>“Afërdita”</i> - Ismail Kadare - <i>“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”</i> - Sofokliu - <i>“Antigona”</i> - Miguel de Servantes - <i>“Don Kishoti”</i> (vepër e përshtatur prej Odhise Grillo-s) <p>Gjatë vitit duhet të analizohen 5 vepra nga lista e propozuar e lektyrave.</p>	<p>- lektyra shkollore</p>	<p>Eneidës... - Lexime dhe diskutime rreth veprave të lexuara – ngjarjeve, personazheve, tematikave të shtjelluara, mesazheve...</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

I. UDHËZIMET DIDAKTIKE

Programi mësimor i lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* është përgatitur sipas kërkesave dhe metodave bashkëkohore, duke respektuar parimin e bashkëlidhjes (korelacionit) dhe integritit të dy fushave programore **Gjuhë** dhe **Letërsi**. Përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* (I-III) realizohen me anën e të dëgjuarit, të kuptuarit dhe të shprehurit (me gojë dhe me shkrim) të temave nga jeta e përditshme; me anën e të lexuarit dhe analizës së teksteve nga letërsia popullore dhe e shkruar, si dhe të teksteve me përmbajtje shkencore-popullarizuese dhe informative nga libri i leximit, revistat dhe nga burimet tjera. Në përmbajtjet e zgjedhura duhet të mbizotërojnë temat e mirësjelljes, të shoqërimit, të dashurisë, të punës, të gëzimeve të jetës, të paqes e lirisë, të bukurive të natyrës, të kujdesit ndaj ambientit jetësor etj.

Të gjitha përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të jenë në bashkëlidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera: me *gjuhën e huaj* (me qëllim të përvetësimit më të lehtë të terminologjisë, ligjeve dhe rregullave gramatikore të të dy gjuhëve); me lëndën e *historisë* (me qëllim të njohjes me zhvillimin historik të gjuhës, kur analizojnë, fjala vjen, këngë nga cikli i Gjergj Kastriotit, si figurë historike dhe si personazh letrar);

me lëndën e *gjeografisë* (me qëllim të njohjes me dialektet e gjuhës shqipe); me *artin figurativ* (me qëllim të paraqitjes figurative të ngjarjeve dhe personazheve të teksteve të interpretuara letrare); me *artin muzikor* (me qëllim të përvetësimit më të mirë të njohurive mbi ritmin, rimën, figurat gjuhësore - asonancën dhe aliteracionin etj.).

Fusha programore *Letërsi*, bashkë me fushën programore *Gjuhë*, janë dy fushat kryesore në mësimdhënien e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Letërsia realizohet me leximin dhe përshkrimin e teksteve poetike, epike dhe dramatike, por dhe të teksteve me karakter fantastiko-shkencor dhe informativ, duke pasur gjithnjë parasysh karakterin e shkollës së mesme profesionale dhe rritjen e shkallëshkallshme të nivelit të njohurive të nxënësve...

Gjuha, ndërkaq, bashkë me nënfushën e komunikimit, përfshin çështjen e përvetësimit të gramatikës e të ligjshmërive të saj, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, për aq sa është e nevojshme për nxënësit e shkollave të mesme profesionale.

Përmbajtjet e dy fushave kryesore programore dhe dy nënfushave (lektyrës dhe komunikimit, të përfshira në kuadër të tyre...) burojnë nga tekstet (artistike, gazetareske, shkencore, fantastiko-shkencore...) dhe ofrojnë mundësi për përvetësimin e të shprehurit dhe krijimtarisë (me gojë e me shkrim) në mënyrë sa më të pavarur e sa më funksionale.

Gjatë përgatitjes së planeve të punës arsimtari duhet t'i ketë parasysh kushtet që ofron shkolla (mjetet dhe pajisjet mësimore që ka në disponim) për realizimin e procesit mësimor, të përllogarisë me kujdes kohën e nevojshme (numrin e orëve) për arritjen e objektivave të caktuar dhe të përdorë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies që do t'ia mundësojnë mbylljen e suksesshme të vitit shkollor.

I. STANDARDET E VLERËSIMIT

Nxënësit do të notohen në mënyrë permanente gjatë tërë vitit dhe përmes testimit ekstern.

Notimi permanent nënkupton vlerësimin e dijes dhe aftësive të nxënësit gjatë vitit shkollor. Për këto është paraparë vlerësimi/ notimi permanent në të dy semestrat.

Vlerësimi/ notimi i njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve duhet të jetë valid dhe i përgjegjshëm. Ai (vlerësimi/ notimi) duhet të bëhet përmes testimeve, përgjigjeve gojore, punëve praktike...

Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes testeve dhe detyrave të kontrollit.

Në rast të mospasurisë së nxënësit gjatë testimit, ata i nënështrohen riprovimit.

II. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

NOTIMI DHE KONTROLLIMI DIAGNOSTIK

Në fillim të vitit mësimor arsimtari bën notim dhe kontrollim diagnostik, me qëllim të verifikimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve të fituara përgjatë vitit shkollor pararendës. Arsimtari mund ta realizojë këtë me ndihmën e instrumenteve të ndryshme: përmes testeve diagnostike, përmes fletëzave anketuese, përmes pyetjeve gojore të përgatitura e të mirëmenduara nga ana e tij, përmes shkrimit të teksteve të shkurta etj. Rezultatet e fituara paraqesin pasqyrën e njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve dhe si të tilla shërbejnë edhe si pikënisje për planet e mëpastajme për realizimin e Programit mësimor dhe përparimin e procesit kompleks të vlerësimit gjatë vitit shkollor.

NOTIMI FORMATIV

Gjatë viteve mësimore preferohet edhe vlerësimi formativ që mundëson notimin më objektiv të arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe të caktuar. Këtë tip notimi arsimtari mund ta realizojë me shfrytëzimin e më shumë metodave të notimit:

- bisedave mes nxënësit dhe arsimtarit;
- prezentimeve gojore;
- hartimeve me shkrim;
- testeve;
- detyrave të shtëpisë.
- portfolieve – mbledhjes së treguesve për arritjet e secilit nxënës, siç mund të jenë krijimeve origjinale të nxënësve...

Portfoliet duhet të jenë të njohura për prindërit e nxënësve që edhe ata të mund të kontribuojnë në realizimin sa më të mirë të mësimin të lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Portfoliet e nxënësit plotësohen me të dhëna gjatë viteve të ardhshme shkollore.

Këto metoda të notimit arsimtari mund t'i vlerësojë dhe t'i kontrollojë me lista të veçanta të evaluimit për çdo nxënës, të përgatitura paraprakisht, të cilat plotësohen me çdo aktivitet konkret. Rezultatet e fituara të arritjeve të nxënësve janë të arritshme për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre.

NOTIMI SUMATIV

Në bazë të të dhënave të tërësishme të fituara nga ndjekja dhe kontrollimi i të arriturave të nxënësve gjatë periudhës së realizimit të Programit mësimor, arsimtari e konstaton përparimin e çdo nxënësi veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore. Nga notat e formuara sumative, të formuluar për çdo nxënës, duke u udhëhequr gjithnjë nga nivelet e arritjeve, gjatë një periudhe të caktuar kohore, arsimtari vendos notat përkatëse numerike.

II. KUSHTET HAPSINORË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Për të realizuar qëllimet e parapara me programin mësimor, lënda **Gjuhë shqipe dhe letërsi** duhet të realizohet në mësonjëtoare apo kabinete përkatëse...

Mjedisi i mësimdhënies duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-4061/1 të datës 31.05.2007.

III. NORMATIVI PËR KUADRIN ARSIMOR

Lëndën **Gjuhë shqipe dhe letërsi** në shkollat e mesme profesionale 3 vjeçare mund ta ligjërojnë mësimdhënësit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)

IV. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: *1.09.2013*

Përbërja e ekipit profesional

1. Nexhbedin Sulejmani - këshilltar pedagogjik, BZHA, njësia rajonale Kumanovë (koordinues)
2. Prof. dr. Fatmir Sulejmani - Ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës
3. Saranda Oamani - Lika - "Nikolla Shtejn" (shkolla e mesme medicinale, Tetovë)
4. Ajten Ajdini Kadriu - SHMQSH "Cvetan Dimov" Shkup

Потпис и датум на утврдување на наставната програма

Наставната програма по албански јазик за прва година на средното стручно образование со тригодишно траење, на предлог на Бирото за развој на образованието, ја утврди министерот за образование и наука

МИНИСТЕР,

Спиро Ристовски

Изготвил: Неџмедин Сулејмани, советник
Контролирал: Трајче Георгиевски, раководител на одделение
Одобрил: м-р Митко Чешларов, раководител на сектор
Директор: м-р Весна Хорватовиќ

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
Бр. 11-5495/1 од 01.10.2013 година
Скопје